



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.204/24

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS** - Dhomat e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami, në çështjen përmbarimore të kreditorit Ministria e Shëndetësisë - Inspektorati Farmaceutik, me seli ne Prishtinë ndaj debitorit L.F. – Barnatore “Pico Pharm 19” shpk me seli ne Vushtrri, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, te ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale te Kosovë – Dhomat e Shkalles se Parë, KPPP nr.2582/22 të datës 20.11.2023, me datë 05.06.2024, mori këtë:

### A K T V E N D I M

**REFUZOHEȚ** e pathemeltë ankesa e debitorit debitorit L.F. – Barnatore “Pico Pharm 19” shpk me seli ne Vushtrri, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale te Kosovës - Dhomat e Shkalles se Parë, KPPP nr.2582/22 të datës 20.11.2023, **VËRTETOHEȚ**.

### A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovë – Dhomat e Shkalles se Parë, me aktvendimin e atakuar KPPP nr.2582/22 të datës 20.11.2023, e ka refuzuar si te pabazuar prapësimin e debitorit L.F. – Barnatore “Pico Pharm 19” shpk me seli ne Vushtrri, i ushtruar kundër urdhrit përmbarimor Pnr.963/22 te datës 10.11.2022, te Përmbaruesit Privat Ilmi Miftaraj, për territorin e Gjykatës Themelore ne Mitrovicë.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori për shkak të shkeljes se dispozitave të procedurës përmbarimore, me propozim qe Gjykata e shkalles se dytë, ta aprovoj këtë ankesë si te bazuar, ta refuzoj propozimin për përmbarim dhe aktvendimin e ankimuar ta prish.

Gjyqtari individual i Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

- Ankesa e debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori, ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit, në bazë të dokumentit përmbarues-Vendimit nr.10/JG-019-20 te datës 30.04.2020 i lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë, i formës se prerë me date n 02.09.2022 dhe i ekzekutueshëm nga data 02.09.2022.

Përmbaruesi Privat Afet Mjeku duke vepruar sipas propozimit për përmbarimin e kreditorit, me urdhrin përmbarimor P.nr.963/2022 te datës 10.11.2022, e ka caktuar përmbarimin në bazë të dokumentit përmbarimor nga i cili rrjedh detyrimi i debitorit ndaj kreditorit ne shumën prej 1,000.00 euro, me kamatë prej 8% nga dita e lejimit te përmbarimit e deri ne pagesën definitive si dhe kompensimin e shpenzimeve te përmbaruesit privat.

Ndaj këtij urdhri debitori me datë 24.11.2022, ka parashtruar prapësim, me arsyetimin se ne rastin konkret kemi te bëjmë me vërtetim jo te plotë te gjendjes faktike, pasi qe nga vendimi i atakuar pretendohet se këtu pronarja e barnatores L.F., ka kryer aktivitet farmaceutik ne barnatore, derisa me rastin e inspektimit te kryer e njëjtë nuk ka prezantuar dëshmi mbi profesionin e sak, e po ashtu ne te njëjtën kohe ka munguar farmacistja e kësaj barnatore. Andaj pala debitorë, propozon qe gjykata ta aprovoj ne tërësi këtë prapësim, urdhrin përmbarimor ta anuloj, ta detyroj kreditorin ti paguaj shpenzimet procedurale si dhe ta aprovoj kërkesën e debitorit.

Gjykata Komerciale e Kosovë – Dhomat e Shkalles se Parë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit dhe shkresave tjera, ka nxjerrë aktvendimin KPPP nr.2582/22 të datës 20.11.2023 me të cilin e ka refuzuar si te pabazuar prapësimin e debitorit duke vendosur si në dispozitiv të njëjtit. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka arsyetuar se pretendimet e debitorit janë te paargumentuara dhe jo siç parashihen me nenin 69 par.4 te LPP, pastaj i referohet nenit 324 par.4 te LPP ne lidhje me pretendimin e debitorit se përmbaruesi privat ka cenuar kompetencën territoriale, ndërsa sa i përket pretendimeve te debitorit se Kryeinspektorë Shëndetësor ka vërtetuar ne mënyrë te gabuar gjendjen faktike, gjykata gjeti se pretendimi i tillë, nuk qëndron sepse nuk është ne kompetencën e gjykatës qe te vërtetohet gjendja për te cilën pretendon i njëjti, përndryshe arsyeton se prapësimi do te refuzohet pasi qe propozimi për përmbarim është ngritur sipas vendimit nr.10/JG-019-20 te datës 30.04.2020 i formës se prerë dhe i ekzekutueshëm, ndërsa sa përket çështje se padisë se ngritur ne konflikt administrativ gjykata sqaron faktin se padia e ngritur nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit ne procedurën administrative.

Gjykata Komerciale –Dhoma e Shkallës e Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka marr aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, i njëjti është i kuptueshëm dhe i qartë, prandaj vendimin e gjykatës, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e shkalles e dytë, duke vlerësuar se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsy se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga nenii 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Dhoma e Shkalles e dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka konstatuar drejtë faktin se Vendimi i lëshuar nga ministria e Shëndetësisë –Inspektorati nr.10/JG-019-20 te datës 30.04.2020, i formës se prerë nga data 02.09.2022 dhe i ekzekutueshëm nga data 02.09.2022, është dokument përmbarues, konform nenit 22 paragrafi 1 pika 1.1 të LPP-së, e cila përcakton se “*dokument përmbarimor është vendimi përmbarues i dhënë ne procedurë administrative dhe aktpajtimi (ujdia)*”, nenit 24 par.3 te LPP i cili thotë se: “*vendimi i dhënë ne procedurë administrative është përmbarimor po qe se i tillë është bërë sipas rregullave me te cilat është rregulluar procedura e tillë*” si edhe nenit 27 paragrafi 1, i cili thotë se: “*dokumenti përmbarimor*

*është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përbushjes se detyrimit*". Nga del se edhe kjo gjykatë vlerëson se Vendimi i lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë –Inspektorati Farmaceutik me nr.10/JG-019-20 te datës 30.04.2020 përbën titull juridik për përmbarim si dhe konsideron se gjykata e shkalles se parë ka konstatuar drejtë rrethanat mbi bazën e të cilave është lejuar përmbarimi përfshirë kushtet nga të cilat varet lejueshmëria e përmbarimit.

Andaj edhe kjo gjykatë e vlerëson përfundimin juridik te gjykatës se shkalles se parë, i ka analizuar edhe pretendimet e debitorit por qe te njëjtat rezultojnë te pabazuara ne prova dhe fakte konkrete, ashtu siç parashihet me nenin 69.4 te LPP, te njëjtat mbresin vetëm te natyrës deklarative nga rezulton se nuk janë plotësuar arsyet ligjore nga neni 71 par.1 te LPP ashtu qe nuk ka kushte për anulim te urdhrit përmbarimor.

Përndryshe, në procedurën përmbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarimor i cili përban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarimin.

Kompetenca e Gjykatës Komerciale –Dhoma e Shkalles e Dytë ne Prishtinë për te vendosur nga ana e gjyqtarit individual ne shkallë te dytë bazohet ne dispozitën e nenit 3 par.2 te LPP me te cilën është paraparë se ne shkallen e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga sa u tha me lartë në kuptim të nenit 209, par.1, pika b), të LPK-së e lidhur me nenin 17 të LPP u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
**Dhoma e Shkalles se Parë**  
**K.DH.SH.II.nr.204/24, me datë 05.06.2024**

**Gjyqtari**  
**Faton Bajrami**